REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorëzuar
Primljeno/Prodato
Recieved/Delivery 29.10 2018 viti god year

Organ./Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr.Prot: Br.Prot: Prot.No:	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKBHIHCM	6405/2018		1/3

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.629/2018

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Hajzer Salihu-kryetar, Lela Petkoviç dhe Shkëmb Manaj-anëtarë, me Sabile Avdyli-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokolli 5766/2018 të datës 05.10.2018 të parashtruar nga ankuesja Edona Berisha, me adresë banimi në Rr" e Medines" nr.15 në Prizren, kundër organit të punësimit-Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në Seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 29.10.2018

V E N D I M

I. Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër protokolli 5766/2018 të datës 05.08.2018, e parashtruar nga ankuesja Edona Berisha.

A r s y e t i m

Ankuesja Edona Berisha, ka aplikuar në konkursin e shpallur Nr.01-123/A të datës 05.07.2018 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë dhe Furnizim në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti". E pakënaqur me njoftimin me nr.03-253/3 të datës 13.08.2018 për përzgjedhjen e kandidatit të suksesshëm, ankuesja më datë 23.08.2018 ka parashtruar ankesën me numër 03/260 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti".

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", me Vendimin me Nr.03-285 të datës 11.09.2018 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pabazuar.

Ankuesja e pakënaqur me Vendimin me Nr.03-285 të datës 11.09.2018 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", më datë 05.10.2018 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5766/2018 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 08.10.2018 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti". Më datë 17.10.2018, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", bashkë me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5766/2018 të datës 05.10.2018 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi me nr.233/2018 i datës 14.09.2018 për

anulimin e konkursit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë dhe Furnizim"; Vendimi i datës 11.09.2018 me nr.03-285 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren; Kërkesë për qasje në dokumente të kundër kandidatëve e datës 27.08.2018; Kërkesë për qasje në dokumente të kundër kandidatëve e datës 16.08.2018; Njoftimi për intervistë me gojë i datës 08.08.2018; Njoftim për kandidatin e suksesshëm i datës 13.08.2018 me nr.03-253/3; Njoftim për listën e ngushtë i datës 27.07.2018; Vendim mbi caktimin U.d Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë dhe Furnizim i datës 02.05.2018; Kopja e konkursit e datës 05.07.2018; Kërkesa për punësim për Edona Berisha; Kontratë e marrëdhënies së punës e datës 01.10.2010; Kontratë për themelimin e marrëdhënies së punës prej datës 01.07.2010 deri më datën 31.12.2010; Vërtetim i datës 01.11.2012; Letër reference e datës 01.10.2012; Referencë e datës 01.11.2012; Autorizim i datës 22.10.2012; Referencë e datës 28.03.2013; Akt emërimi i datës 03.12.2012; Curriculum Vitae; Letër reference e datës 29.09.2014; Letër rekomandimi shtator 2014; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2011; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2010; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2013; Diplomë e datës 23.04.2014 Master i Shkencave Teknike-Arkitekturë në Universitetin e Prishtinës; Çertifikatë e datës 08.06.2013; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën Zyrtar I Infrastrukturës; Ankesa e datës 23.08.2018 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Universitetin e Prizrenit; Autorizimi i MAP-it i datës 28.06.2018; Vendim i datës 23.07.2018 për themelimin e Komisionit Përzgjedhës; Deklaratë e datës 23.07.2018; Raporti Final me Rekomandim nga KPSHC; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Regjistri i aplikacioneve i datës 20.07.2018; Kopja e testit me shkrim i datës 01.08.2018 për Egzon Kryeziu; Kopja e testit me shkrim për Edona Berisha; Vlerësimet individuale për ankuesen dhe kandidatin e përzgjedhur; Kërkesa për punësim e datës 16.07.2018 për Edona Berisha bashkë me dokumentacionin e kërkuar, si dhe përgjigje në ankesë e datës 17.10.2018 nga organi i punësimit bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara si nga ankuesja ashtu edhe nga organi i punësimit, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ me ankesën e ankueses Edona Berisha, është bërë i pamundur *sepse:*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 29.10.2018 nga Zyra e Personelit të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" ka pranuar njoftimin se me Vendimin numër 308/03-331 të datës 26.10.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", është bërë zbatimi i Vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me numër 246/2018 të datës 17.10.2018, me të cilin vendim është anuluar procedura e rekrutimit shpallur me Nr.01-123/A me datën 05.07.2018 për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë dhe Furnizim në Universitetin e Prizrenit "Ukshin Hoti", ne të cilën procedurë kishte aplikuar edhe ankuesja Edona Berisha.

Bazuar mbi këtë gjendje faktike dhe juridike Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pa mundur, sepse në rastin konkret me Vendimin me nr.308/03-331 të datës 26.10.2018 të nxjerrë nga Sekretari i Përgjithshëm i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti" është anuluar konkursi për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Infrastrukturë dhe Furnizim, andaj Kolegji konstaton se janë pjekur kushtet ligjore për përfundim të procedimit administrativ ashtu siç parashihet me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë".*

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:
- Ankueses, Edona Berisha;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti";
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në të Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti";
- Arkivit të KPMSHCK- së.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.629/2018;

Hajzer Salihu
Kryetar i Kolegjit

Sabile Avdyli
Procesëmbajtëse
Sabile Avdyli